



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËSË

Nr. 24/2/1 Prot.

Tiranë, më 14.06.2023

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1211/1, datë 26.06.2012.

SHOQËRISË “BLERIM-PLATIN” SH.P.K

Njësia Bashkiake Nr. 6, Rr. “Besim Alla”, Nr. Pasurie 343/142, Tiranë.

Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “BLERIM-PLATIN” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1211/1, datë 26.06.2012, për mineralin krom, në Objektivin “Maja e Lajthizës, Qaf Mesi”, Bashkia Klos, Qarku Dibër.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 1322, datë 28.02.2023, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 2412, Prot., datë 02.03.2023, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1211/1, datë 26.06.2012, për mineralin krom, në Objektivin “Maja e Lajthizës, Qaf Mesi”, Bashkia Klos, Qarku Dibër, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar, lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitet 2021 dhe 2022.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr. 1211/1, datë 26.06.2012, për mineralin krom, në Objektivin “Maja e Lajthizës, Qaf Mesi”, Bashkia Klos, Qarku Dibër që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë

sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1211/1, datë 26.06.2012, për mineralin krom, në Objektivin "Maja e Lajthizës, Qaf Mesi", Bashkia Klos, Qarku Dibër, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI

ILIR BEJTJA

